



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Shtojca 11

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[22.05.2024]

Drejtuar: **TUV AUSTRIA HELLAS LTD (DEGA SHQIPERI)**

Adresa: *Rruga "Ibrahim Rugova", Ndertesa 28, Hyrja 28, Hyrja 9, Apartamenti 30, Kutia Postare 1019, Njesia Administrative Nr.5, Tiranë.*

Procedura e prokurimit: "Procedure e hapur e Thjeshtuar" – Kontratë publike – Shërbime, me objekt: **"Shërbim i auditim dhe certifikim sipas standardit iso 27001:2022 nga një trupë certifikuese"** me fond limit: **5,000,000** (pesë milion) **Lekë pa TVSH**, me numër reference: **REF-04056-05-08-2024** dhe me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga nënshkrimi i kontratës.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Procedure e hapur e Thjeshtuar" – Kontratë publike – Shërbime, me objekt: **"Shërbim i auditim dhe certifikim sipas standardit iso 27001:2022 nga një trupë certifikuese"** me fond limit: **5,000,000** (pesë milion) **Lekë pa TVSH**, me numër reference: **REF-04056-05-08-2024** dhe me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [13.05.2024] [Nr.24]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. "TUV AUSTRIA HELLAS LTD (DEGA SHQIPERI)"** **NIPT: L31617001M**  
Vlera e ofertës: **4.100.000 Lekë pa TVSH**  
(katërmilion e njëqindmijë)

**2. "e-Cert" SHPK** **NIPT: M02312022A**  
Vlera e ofertës: **4.350.000 Lekë pa TVSH**  
(katërmilion e treqind e pesëdhjetëmijë)

*Adresa: Rruga "Xhanfize Keko" Ish Topografia Ushtarake, Tiranë*

### 3. “LEGAL CERT” SHPK

NIPT: L51829010K

Vlera e ofertës: **2.400.000 Lekë pa TVSH**  
(dymilion e katërqindmijë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

#### 1. “e-Cert” SHPK

NIPT: M02312022A

Vlera e ofertës: **4.350.000 Lekë pa TVSH**  
(katërmilion e treqind e pesëdhjetëmijë)

- Rezulton se oferta nuk është paraqitur e sakte dhe e plote, sikunder publikuar në DST. Referuar tabelës së publikuar nga autoriteti kontraktor, në Formularin e Ofertes janë parashikuar 2 (dy) zera shërbimi. Në ofertën e operatorit ekonomik është paraqitur vetëm zeri i parë dhe mungon zeri i dytë "Mbikëqyrje/mirëmbajtje e certifikimit", gjë që nuk mundeson vlerësim të detajuar të ofertes në zërat e saj përberës.

Per kete arsye, bazuar në nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në përcaktimet e Seksionit 1 të DST-ve "Udhëzime për operatorët ekonomike", pika B/4, ku përcaktohet se Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertes në përputhje me formularin e paraqitur pa ndryshime dhe me të gjithë informacionin e kërkuar, kjo ofertë refuzohet dhe operatori ekonomik “e-Cert” SHPK \_\_ **Nuk Kualifikohet.**

#### 2. “LEGAL CERT” SHPK

NIPT: **L51829010K**

Vlera e ofertës: **2.400.000 lekë pa TVSH**  
(dymilion e katërqindmijë)

Rezulton, **oferta e “LEGAL CERT” SHPK**, me vlerë 2.400.000 Lekë pa TVSH, është më e vogël se vlera e 75% të fondit limit prej 5.000.000 Lekë pa TVSH, pra është ulur më shumë sesa 25%, ndaj si e tillë **konsiderohet ofertë anomalisht e ulët.**

Në këto kushte, bazuar në nenin 93, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, ku citohet se: “*Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.*” atëherë Komisioni vendosi të refuzojë ofertën e paraqitur, nga “LEGAL CERT” SHPK ofertë e cila \_\_ **Nuk Kualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “*TUV AUSTRIA HELLAS LTD (DEGA SHQIPERI*” me adresë: *Rruga Ibrahim Rugova, Ndertesa 28, Hyrja 28, Hyrja 9, Apartamenti 30, Kutia Postare 1019, Njesia Administrative Nr.5, Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4.100.000 (katër milion e njëqind mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

---

Adresa: Rruga “Xhanfize Keko” Ish Topografia Ushtarake, Tiranë